

20192023205

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR PAGESËN E RROGAVE
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

Neni 1

Në Ligjin për pagesën e rrogave në Republikën e Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 70/94, 62/95, 33/97, 50/2001, 26/2002, 46/2002, 37/2005, 121/2007, 161/2008, 92/2009, 97/10, 11/12, 145/12, 170/3, 139/14 dhe 147/15), në titull dhe në tërë tekstin fjalët: “Republika e Maqedonisë”, zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 2

Neni 12 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 800 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit – person juridik, nëse rrogat nuk i paguan apo i paguan në kundërshtim me këtë ligj.

Gjobë në shumë prej 400 eurosh në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik.

Gjobë në shumë prej 100 - 150 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni personit zyrtar të autorizuar në personin juridik.”.

Neni 3

Në Ligjin për ndryshimin e Ligjit për pagesën e rrogave në Republikën e Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 139/14), neni 1 ndryshohet si vijon:

“Punëdhënësi të drejtën e përcaktuar për rrogë në vitin 2019 mund ta zmadhojë për 5%, duke filluar me pagesën për shtator 2019.”.

Neni 4

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të përcaktojë tekstin e spastruar të Ligjit për pagesën e rrogave në Republikën e Maqedonisë.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.